



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:152617

Datë: 28.01.2025

Numri i dokumentit: 06767420

PAKR.nr.729/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti I Krimeve të rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët, Mentor Bajraktari - kryetar, Afërdita Bytyçi dhe Kymete Kicaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesional Fitore Batatina, në çështjen penale të akuzuarit M.S nga Mitrovica, Rr. “Maria Shllaku”, nr.9, për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 229 par.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje KPPK), duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Krimeve të rënda, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.353/2007, të datës 13.11.2024, në seancën e kolegjit me datë 16.01.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.353/2007, i datës 13.11.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.353/2007, të datës 13.11.2024, të akuzuarin M.S, duke vepruar konform nenit 363 par.

1, nënpar. 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, e ka liruar nga akuza për veprën penal, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope nga neni 229 par. 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25.

I akuzuari është liruar nga shpenzimet e procedurës penale, të cilat do të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë Prokuroria Themelore Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, nën shenjë PP.I.nr.348/2007 me dt.15.11.2024, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Prokuroria e Apelit, më parashtrësën me shkrim, PPA/I.nr.665/2024, të datës 20.12.2024, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, u caktua dhe u mbajt seanca e kolegjit në të cilën prezantoi i akuzuari M.S dhe mbrojtësi i tij av. Rexhep Kaçaniku, ndërsa nuk prezantoi Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tij. Mbrojtësi i të akzuarit, av. Rexhep Kaçaniku deklaroi se ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë është e pabazuar, dhe propozoi që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet. I akuzuari M.S deklaroi se e mbështet mbrojtësin e tij në tërësi.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore Mitrovicë, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

*Ankesa është e pabazuar.*

### Pretendimet ankimore

Në ankesë Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktik kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza për arsye se nuk ka prova të mjaftueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, e që kjo vërtetohet nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, procesverbali i bastisjes së shtëpisë të Nexhat Osmanoviq të i cili është dyshuar se i akuzuari ka blerë drogë, pasi që fillimisht janë marr vesh me telefon ku i akuzuari i'a kishte sjellë narkotikët në lagjen e boshnjakëve dhe atë dy herë duke e paketuar ku për çdo gram kishte paguar Nexhat Osmanoviq-in nga 10 €, si dhe e konfirmon se edhe një herë janë takuar në stacion policor, ku e ka njoftë se është personi prej të cilit e ka blerë drogën si dhe ka bërë përshkrimin e automjetit të akuzuarit Ford Fiesta me ngjyrë të bardhë ku ka deklaruar se ja ka dhënë paratë ndërsa i akuzuari M.S i kishte dhënë drogën. Sipas mbrojtjes nga lista e dëshmive e dt. 13.11.2007 vërtetohet fakti se ditën kritike gjatë bastisjes së shtëpisë së N.O janë gjetur 280 gram marihuanë, 5.63 substanca pluhur e dyshuar heroinë e që ka deklaruar se një pjesë e ka blerë nga i akuzuari M.S, e që nga raporti i ekzaminimit kriminalistik të dt.05.12.2007, rezulton se prezent ka qenë heroina me peshë 3.11 gram, kurse nga ekzaminimi i substancës bimore me ngjyrë të gjelbërt ka qenë prezent kanabisi me peshë 267.90 gram. Prokuroria pretendon se aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 par.7 të KPPK-së, në arsyetim gjykata nuk ka përmend provat që janë proceduar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Thekson se vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë se nuk ka mund të vërtetohet ekzistimi i veprës penale është i paargumentuar dhe bie në kundërshtim me provat e cekura. Shton se gjendja faktike nga gjykata është vërtetuar në mënyrë jo të drejtë ka edhe shkelje të ligjit penal sepse në bazë të provave rezulton se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar e tashmë liruar, duke i propozuar Gjykatës së Apelit si më lartë.

### *Gjetjet e Gjykatës së Apelit*

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, dhe as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilave i referohet në ankesë prokurori, ngase dispozitivi i aktgjykimit nuk ka kundërthënie me arsyetimin dhe përmban arsyet e duhura mbi faktet vendimtare të kësaj

çështje penale, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se nga dispozitivi i akuzës nuk rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat që do të përbënin elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar i akuzuari, për faktin se nga administrimi i provave, nuk është vërtetuar pretendimi i prokurorisë se i akuzuari M.Spa autorizim, e me qëllim shitje, të ketë poseduar substancë narkotike dhe të njëjtën pa autorizim t'a kete shitur. Pra, gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe lidhur me to ka paraqitur përfundimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë.

*Të gjeturat e Gjykatës për pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se po të ishin vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë të gjitha provat e ofruara nga prokuroria, do të rezultonte se i akuzuari M.S ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, do të vërtetohej se nga data e pacaktuar, kah fundi i muajit tetor dhe me datën 11.11.2007 në shtëpinë e tij e cila gjendet në rrugën “Marija Shllaku”, nr.7, në Mitrovicë, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike me qëllim të shitjes, të cilat i'a ka shitur të akuzuarit Nexhat Osmanoviq.

Kolegji penal i Gjykatës se Apelit vlerëson se këto pretendime ankimore të prokurorisë nuk qëndrojnë ngase duke u bazuar në faktet e çështjes rezulton, se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se në këtë drejtim nuk kanë mbetur fakte të tjera të rëndësishme në mëdyshe, siç pretendohet në ankesën e ushtruar. Kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se nga administrimi i provave si në faqen 4 të arsyetimit të aktgjykimit të ankimuar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur të vërtetohet fakti se i akuzuari ka poseduar substanca narkotike me qëllim të shitjes së tyre dhe të njëjtat të i'a ketë shitur N.O. Bazuar në provat e administruara nga gjykata shkallës së parë ka rezultuar se janë gjetur substanca narkotike tek i akuzuari tjetër i quajtur N.O, substanca narkotike janë gjetur edhe në lokalin e këtij te akuzuari, për më tepër i njëjti në deklaratimet e tij ka pranuar se ka poseduar narkotikë në kundërshtim me ligjin në fuqi, por nga provat e administruara nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar se i akuzuari M.S ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ngase me asnjë provë konkrete nuk është provuar se i akuzuari i ka shitur substanca narkotike të akuzuarit N.O.

Sipas vërtetimit mbi konfiskimin e sendeve ka rezultuar se pas kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit M.S nuk është gjetur asgjë e dyshimit, e as substancë narkotike. E vetmja provë që e ngarkon të akuzuarin M.S është deklarata e të akuzuarit N.O i cili ka deklaruar se këtë sasi të narkotikëve e ka blerë nga ai. Kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës se shkallës së parë se asnjë provë e vetme nuk dëshmon se i akuzuari ka shitur në këtë rast substanca narkotike të akuzuarit N.O për më tepër as pas kontrollit në shtëpinë e tij nuk është gjetur asgjë. Prokuroria nuk ka arritur ta dëshmojë ndonjë veprim të akuzuarit në drejtim të kësaj vepre penale, e vetmja provë në të cilën thirret prokuroria është deklarata e të akuzuarit N.O. Andaj, edhe me të drejtë gjykata shkallës së parë ka rikujtuar kufizimet që parashihen me nenin 119 par.5 të Kodit të Procedurës Penal, ku përcakton se: *“Deklaratat e të akuzuarit të dhëna në çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim, nuk mund të shërbejnë si provë ndaj të bashkëpandehurve në të njëjtën procedurë penale apo edhe në procedurën e veçuar, përveç kur ky Kod në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se deklarata e tillë mund të shërbej si provë”*. Prandaj, deklaratat e të akuzuarit N.O në raport me të akuzuarin M.S nuk mund të përdoren si provë fajësuese apo provë për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë në raport me akuzën e ngritur kundër të akuzuarit M.S.

Kolegji vëren se në këtë rast prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, se provat të cilat janë paraqitur, janë të pamjaftueshme dhe nuk provojnë dyshimin e bazuar mirë për kryerjen e kësaj vepre penale nga ana e të akuzuarit. Në anën tjetër, nuk mjaftojnë vetëm të dhënat apo indiciet për të provuar fajësinë e një personi të akuzuar, e nevojshme dhe e domosdoshme është që të jetë niveli i lartë i të provuarit, apo thënë ndryshe duhet të provohet me prova konkrete dhe të pranueshme dyshimi i bazuar mirë përmes të cilave pastaj do të dëshmohet fajësia e të akuzuarit. Andaj, edhe me të drejtë gjykata shkallës së parë ka ardhur në përfundim se nga provat e ofruara nga prokurori nuk ka arritur të vërtetoj se i akuzuari M.S ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit, dhe me të drejtë ka vendosur që të akuzuarin t’u liroj nga akuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.nr.348/2007 të datës 27.12.2007, për veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPPK-së.

Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin e arsyeshëm, se nga provat e zbatuara nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën

penale për të cilën është akuzuar, andaj me të drejtë i akuzuari është liruar nga akuza për veprën për të cilën është akuzuar.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të rënda  
PAKR.nr.729/2024 me datë 16.01.2024

B. Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Afërdita Bytyçi

Mentor Bajraktari

Kymete Kica